

ALBESOL Sh.p.k
L42307014K
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Tabela e përmbajtjes

Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve Monetare	4
Pasqyra Përmbledhëse e Aseteve	5
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	6-24

RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR

ALBESOL Sh.p.k
Pasqyra e Pozicionit Financiar
(Shumat në Lekë)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Aktive			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	60,587,620	53,656,120
Aktive afatgjata jo-materiale	9	6,383,351	
Totali i aktiveve afatgjata		66,970,971	53,656,120
Aktive afatshkurtra			
Llogari të arkëtueshme	10	85,239,416	72,127,306
Tatime të parapaguara		0	8,214,649
Paradhënie dhe parapagime	11	20,966,113	64,509,974
Inventarët	12	74,399,152	109,657,487
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	13	13,047,319	5,044,770
Totali i aktiveve afatshkurtra		193,652,000	262,925,169
Totali i aktiveve		260,622,971	316,581,289
Kapitali dhe Detyrimet			
Kapitali aksionar	14	11,000,000	11,000,000
Rezerva e rezultate të mbartura		89,498,256	43,877,689
Total i kapitalit		100,498,256	54,877,689
Detyrime			
Detyrime afatgjata			
Huaja	15	63,359,161	67,397,730
Grante		0	0
Totali i detyrimeve afatgjata		63,359,161	67,397,730
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare e të tjera	16	65,572,146	141,606,558
Provizione	17	0	0
Detyrime të tjera	18	673,683	1,057,158
Të ardhura të shtyra		17,274,126	51,589,653
Detyrime tatimore		13,245,599	52,500
Totali i detyrimeve afatshkurtra		96,765,554	194,305,869
Totali i detyrimeve		160,124,715	261,703,599
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		260,622,971	316,581,288

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 deri 24 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ALBESOL Sh.p.k

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse

(Shumat në Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat			
Të ardhurat nga aktiviteti kryesor	19	672,814,891	316,279,847
Të ardhura shitja e aktiveve materiale	20	860,750	1,169,812
Të ardhura të tjera	21	1,164,480	1,454,090
		674,840,121	318,903,749
Shpenzimet			
Shpenzime materiale		(457,655,991)	(262,161,588)
Shpenzime personeli	22	(24,295,016)	(35,381,296)
Zhvlerësimi dhe amortizimi		(8,703,395)	(3,541,529)
Të tjera shpenzime operative	23	(41,296,919)	(26,100,602)
VI neto e aseteve të dala	17	(784,290)	0
		(532,735,611)	-327,185,015
Kosto financiare neto			
Shpenzime interesi e të tjera financiare	15	(9,419,055)	(3,521,588)
Neto nga këmbimi valutor		(1,695,433)	7,498,498
		(11,114,488)	3,976,910
Rezultati para tatimit		130,990,023	(5,758,447)
Shpenzimi i tatim fitimit	24	(20,190,243)	(124,065)
Rezultati i vitit		110,799,780	(5,882,511)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i Fitimeve gjithëpërfshirëse për vitin		110,799,780	(5,882,511)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 deri 24 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ALBESOL Sh.p.k
Pasqyra e Ndryshimeve në Asete
(Shumat në Lekë)

Pasqyra permbledhese e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jomateriale 2019

Kosto	Ndertesa	Makineri e pajisje	Mjete transporti	Kompjutera dhe pajisje zyre	Aktive jo materiale	Totali
Më 31 dhjetor 2018	37.370.367	15.369.807	7.204.759	3.786.551		63.731.484
Shtesa	4.143.060	1.001.756	5.256.696	2.430.973	7.501.889	20.334.374
Shitja e aktiveve		950.189	730.478	-		1.680.667
Pakësime	367.697					367.697
Më 31 dhjetor 2019	41.145.730	15.421.374	11.730.977	6.217.524	7.501.889	82.017.494
Amortizimi i akumuluar						
Më 31 dhjetor 2018	4.336.882	3.537.173	1.740.945	460.364		10.075.364
Amortizimi i vitit	1.746.883	1.275.436	986.856	839.213	1.120.449	5.968.837
Shitja e aktiveve		479.231	417.146			896.377
Pakësime	101.302					101.302
Më 31 dhjetor 2019	5.982.463	4.333.378	2.310.655	1.299.577	1.120.449	15.046.522
Ylira e mbetur						
Më 31 dhjetor 2018	33.033.485	11.832.634	5.463.814	3.326.187		53.656.120
Më 31 dhjetor 2019	35.163.267	10.087.996	9.420.322	4.917.947	6.381.440	66.970.972



ALBESOL Sh.p.k
Pasqyra e Flukseve Monetare
(Shumat në Lekë)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset monetare nga veprimtari operative		
Rezultati pas llogaritjes së tatim fitimit	110,799,780	(5,882,511)
<i>Rregullime për:</i>		
Humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	0	179
Zhvlerësim	8 2,602,392	(1,802,241)
Amortizim	9 5,968,837	3,506,085
Provizjone	17 0	0
Të ardhura nga grante	21 0	0
Të ardhura nga interesi	-	-
Shpenzime interesi	0	0
Efekti i ndryshimeve të kursit të këmbimit për gjendjen e mjeteve monetare dhe huave të mbajtura në monedhë të huaj	0	0
	119,371,008	(4,178,667)
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:</i>		
Rritja në llogari të arkëtueshme	39,414,992	82,447,774
Rënia/(rritja) në Inventare	35,258,335	(47,749,990)
Rënia/(rritja) në garancitë bankare	-	0
Rritja në llogari të pagueshme	(95,428,455)	(61,618,782)
(Rënia)/rritja në të ardhura të shtyra	-	0
(Rënia)/rritja në të tjera të pagueshme	0	0
	(20,755,128)	3,006,696
Interesa të marra	-	-
Tatim fitimi i paguar	-	0
Interesa të paguara	0	0
Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë operative	0	0
Flukset monetare nga veprimtari investuese		
Shuma neto nga aktivet afatgjata materiale	8	
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	8 (19,283,688)	(5,234,410)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	9	
Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë investuese	(19,283,688)	(5,234,410)
Flukset monetare nga veprimtaritë financuese		
Shuma neto nga huamarrje	15 (6,150,432)	29,927,693
Dividend të paguar	14 (65,179,212)	(2,600,000)
Flukset monetare neto nga veprimtaritë financuese	(71,329,644)	27,327,693
Rritja/(pakësimi) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	8,002,550	(9,006,381)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	5,044,769	14,051,150
Efekti i ndryshimeve të kursit të këmbimit për gjendjen e mjeteve monetare dhe huave të mbajtura në monedhë të huaj	0	0
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës	13 13,047,319	5,044,769

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 deri 24 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



ALBESOL Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. Shoqëria raportuese

ALBESOL Sh.p.k ("Shoqëria") është themeluar dhe regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 16 nëntor 2014. Shoqëria zotërohet plotësisht nga Ortaku i vetëm Elona Pulti.

ALBESOL Sh.p.k operon në fushën e studim projektim, supervizion dhe ndërtim linjash për energjinë elektrike, nënstacione elektrike TL, TM, centrale dhe hidrocentrale. Prodhim materiale elektrike e të tjera të lidhura me këto shërbime.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është: Fushas nr 64/3, Baldushk, Shqipëri.

Adresa e Ortakut të vetëm është: Rr. e Elbasanit, Tiranë, Shqipëri .

2. Baza e kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar për Njësitë e vogla e të Mesme (SNRF për NJVM).

3. Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë të paraqitura në Lek, e cila është monedha funksionale dhe prezantuese e Shoqërisë.

5. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjës gjykimin, vlerësimet dhe supozimet e tyre që ndikojnë në procesin e zbatimit të politikave kontabël të njësisë raportuese dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurive dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 8.

a) Vlerësimi i Drejtimit në lidhje me parimin e vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë.

Shoqëria është regjistruar në vitin 2014 (shiko shënimin 1). Përgjatë aktivitetit ka operuar në fushën e punimeve në Linja elektrike të TL dhe TM dhe prodhimin e paneleve elektrike, dhe ky aktivitet ka rezultuar fitimprurës .

Në 2018, Shoqëria ka pësuar një humbje , e cila u adresua kryesisht nga ndryshimet ligjore që prekën njërin nga klientët e rëndësishëm të vitit , duke mos vijuar me përfundimin e projektit, duke penalizuar në këtë mënyrë shoqërinë.

Por në 2019, shoqëria rezulton me aktivitet të shtuar, që sjellin si pasojë realizimin e një fitimi para tatimit në shumën 130,990,023 lekë.

Tregues ky shumë i rëndësishëm , që flet për një vazhdimësi të padiskutueshme të biznesit .

Menaxhimi pret që Shoqëria të vazhdojë të jetë me fitim në të ardhmen dhe e aftë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë.

b) Gjykimet

Informacioni rreth gjykimit të bërë në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare është përfshirë në shënimin 19 Të ardhurat.



ALBESOL Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

c) Supozimet dhe paqartësitë e vlerësimit

Informacioni mbi supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit që mund të kenë një rrezik të konsiderueshëm për të sjellë një rregullim material në të ardhmen, përfshihet më poshtë:

Zhvlerësimi i pajisjeve

Vlerësimi i vlerës së pajisjeve është çështje e gjykimit bazuar në përvojën me operacione të ngjashme, kushtet aktuale dhe parashikimet për të ardhmen. Shih rezultatet e testit të zhvlerësimit të detajuara në shënimin 8.

Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat

Drejtimi beson se llogaritja e tatimit mbi të ardhurat është e përshtatshme pavarësisht nga ndryshimet e shpeshta të mjedisit tatimor shqiptar dhe legjislacionit ekzistues në fuqi dhe beson se çdo auditim i ardhshëm tatimor nuk do të ketë efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar të Shoqërisë, rezultateve të operacioneve ose flukseve të mjeteve monetare. Megjithatë, për shkak të natyrës së ligjit të tatimit mbi të ardhurat, praktikave dhe udhëzimeve përkatëse, nuk është e mundur të sigurohemi që pozicioni aktual i ligjit të taksave do të mbetet i pakontestueshëm nga autoritetet tatimore.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Një numër i politikave dhe shënimeve të kontabilitetit të Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, si për aktivet dhe për detyrimet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe / ose zbulimi bazuar në metodat e mëposhtme. Kur është e aplikueshme, është përdorur informacion i mëtejshëm në lidhje me supozimet e bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë në shënime specifike për atë aktiv ose pasiv.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme nga klientët janë neto, pasi nuk është përlogaritur zhvlerësim. Llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë kanë një vlerë të drejtë të vlerësuar afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme nga furnitorët mbahen me kosto. Llogaritë e pagueshme të Shoqërisë kanë një vlerë të drejtë të vlerësuar afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.

Huamarrjet

Më 31 dhjetor 2019, vlera e drejtë e huamarrjeve përafrohet me vlerën e tyre kontabël për shkak të normave të interesit që përafrojnë normat e tregut për kreditë e ngjashme.

6. Politikat bazë kontabël

Shoqëria ka aplikuar vazhdimisht politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat të paraqitura në këto pasqyra financiare.

a) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin të këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet në valutë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja nga mjetet monetare është diferenca ndërmjet koston së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe koston së amortizuar në monedhë të huaj me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitet jomenetare dhe detyrimet në monedhë të huaj, të përcaktuara me kosto historike, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat në monedhë të huaj që rrjedhin nga rivlerësimi njihen në fitim ose humbje dhe janë paraqitur në një baze neto (shiko politikën kontabël 6(f)).



ALBESOL Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

6. Politikat bazë kontabël (vazhdim)

b) Njohja e të ardhurave

Shoqëria është e përfshirë në ofrimin e punimeve dhe tregtimit të mallrave elektrik. Të ardhurat e përfituara nga ofrimi i punimeve dhe tregtimit të mallrave elektrik, njihen në momentin kur punimet dhe mallrat e dhëna janë kryer/lëvruar.

c) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në momentin kur kryhen.

d) Kosto e materialeve të shitura

Kostot e materialeve të shitura njihen në momentin e përdorimit në punime /shitjes së materialit, vlerësuar me koston mesatare të tyre. Materialet e përdorura/shitura kanë një vlerë të drejtë të vlerësuar afërsisht të barabartë me vlerën e tyre historike për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.

e) Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetsore, që u sigurojnë përfitime pensioni punonjësve me daljen e tyre në pension dhe përfitime raporti mjeksor në kushtet e paaftësisë së përkohshme për punë apo përfitime nga raporti i barrëindjes. Autoritetet ligjvënëse janë përgjegjëse për përcaktimin e limiteve ligjore për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetsore. Kontributet e Shoqërisë për sigurimet shoqërore e shëndetsore ngarkohen në shpenzime të shoqërisë në momentin kur ndodhin.

f) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare dhe kostot financiare të Shoqërisë, përfshijnë të ardhurat nga interesi, shpenzimet e interesit dhe fitim/ humbjet nga monedha e huaj. E ardhura ose shpenzimi i interesit njihet duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet në monedhë të huaj janë të raportuara në bazë neto si e ardhur financiare ose kosto financiare.

g) Grantet

Një grant njihet fillimisht si e ardhur e shtyrë kur ka një siguri që do të merret dhe që Shoqëria do të jetë në përputhje me kushtet e lidhura me të. Ato më pas njihen në fitim ose humbje si të ardhura të tjera mbi një bazë sistematike gjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

h) Tatimi

Shpenzimi i tatimit përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit fitimit njihet në fitime ose humbje përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejtë në kapital, ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit dhe duke marrë në konsideratë çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Shuma e tatimit të pagueshëm ose të marrë i periudhës është vlerësuesi më i mirë i shumës së tatimit të pritshëm për t'u paguar ose marrë. Ai matet duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë llogaritet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura, kreditimet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që një fitim i tatueshëm i ardhshëm do të gjenerohet, i cili mund të përdoret dhe në rast se fitime të ardhshme të tatueshme mund të përcaktohen në bazë të planit të biznesit të vitit pasardhës. Aktivitet tatimore të shtyra



ALBESOL Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen deri në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi nga tatimi do të realizohet;

6. Politikat kontabël (vazhdim)

(ii) Tatimi i shtyrë

Reduktime të tilla kanë ndikim të kundërt kur probabiliteti i tatim fitimit të ardhshëm përmirësohet.

Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë vlerë kur mund të pritet që fitimet e tatueshme në të ardhmen do të realizohen kundrejt së cilës ato mund të përdoren.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë, duke përdorur normat e tatimit të miratuara në datën e raportimit. Llogaritja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat e tatimeve, që do të rrjedhë si pasojë e mënyrës me të cilën Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose të shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

i) Aktivitet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktivitet të vetë-ndërtuar përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, dhe çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar. Kur pjesë të një aktivitet kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si pjesë më vete pajisjeje (zëra të rëndësishëm ; mbi 15 % të koston historike të aktivitet).

Fitimi ose humbja nga nxjerrja jashtë përdorimit të një aktivitet përcaktohet duke krahasuar të ardhurat nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël të pajisjes dhe njihet neto tek të ardhurat/shpenzimet e tjera operative si fitim ose humbje.

(ii) Kosto të mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një aktivitet njihet me vlerën kontabël të aktivitet nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike do të gjenerohen për Shoqërinë dhe kostoja e tij mund të llogaritet me besueshmëri. Kostot e funksionimit të përditshëm të pajisjes njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje bazuar në metodën mbi vlerën e mbetur të aktivitet në fillim të ushtrimit, korrektuar me periudhën efektive gjatë ushtrimit (data që ata janë në gjendje në/për përdorim). Norma e amortizimit vjetor është përcaktuar si më poshtë:

Ndërtesa e instalime të përgjithshme	5 %
Pajisje e makineri	20 %
Mobilje dhe pajisje zyre	20 %
Pajisje Kompjuterike dhe pajisje zyre	25 %

Aktivitet e dhëna hua amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër midis huasë dhe jetës së tyre të dobishme.

i) Aktivitet jo materiale

Licencat e blerjes së programeve kompjuterike nga Shoqëria paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar. Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë të metodës lineare përgjatë jetës së aktivitet jo material nga data që ai është në gjendje për përdorim.

Norma e amortizimit vjetor është përcaktuar si më poshtë:

Licencat /Të drejtat ekskluzive të prodhimit 15 %

6. Politikat koatabël (vazhdim)



ALBESOL Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

j) Aktivet dhe detyrimet financiare

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivative.

(i) Aktive dhe detyrime financiare jo-derivative – Njohje dhe Mosnjohje (çregjistrim)

Shoqëria fillimisht njihet huatë dhe llogaritë e arkëtueshme në momentin kur ato ndodhin. Aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në momentin e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukset monetare kontraktuale në një transaksion në të cilat në mënyrë substanciale të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar janë transferuar, ose as i transferon dhe as nuk mban në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk ka kontroll mbi aktivin e transferuar. Interesat nga aktive të tilla financiare të çregjistruara, të krijuara apo të mbajtura nga Shoqëria, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Shoqëria nuk e njihet një detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale janë shlyer, anuluar ose kanë skaduar.

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto e përcaktuar në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Shoqëria aktualisht ka një të drejtë ligjore të zbatueshme të kompensojë shumat dhe synon ose të shlyejë ato në bazë neto ose të krijojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

(ii) Aktive financiare jo-derivative – Matje

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus ndonjë kosto e drejtpërdrejtë transaksioni. Pas njohjes fillestare, ato njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus çdo humbje nga zhvlerësimi (shiko shënimin 6(n)(i)).

(iii) Detyrime financiare jo-derivative – Matje

Detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë minus ndonjë kosto e drejtpërdrejtë transaksioni. Pas njohjes fillestare, këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kontabiliteti për të ardhurat dhe shpenzimet është diskutuar në politikat kontabël 6(f).

k) Kapitali aksionar

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë njihet në vlerë nominale.

l) Provigjone

Një provigjon njihet, nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të shkuarën, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provigjonet përcaktohen duke aktualizuar flukset monetare të ardhshme me një normë që reflekton vlerësimet aktuale të tregut me vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Efekti kohor i aktualizimit njihet si kosto financiare.

m) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar i cili nuk është mbajtur me vlerën e drejtë në fitim ose humbje vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që ai është i zhvlerësuar. Një aktiv financiar është konsideruar të jetë i zhvlerësuar nëse evidenca objektive tregojnë se një ose më shumë ngjarje kanë pasur një efekt negativ në vlerësimin e fluksit të mjeteve monetare të ardhshme të këtij aktivi dhe që mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara përfshin mos pagesë ose shkelje nga debitori, ristrukturimin e një shume të detyrimit ndaj Shoqërisë të tilla që Shoqëria përndryshe nuk do ta konsideronte, apo tregues që një debitor ose huadhënës po falimenton.

6. Politikat kontabël (vazhdim)



ALBESOL Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

m) Zhvlerësimi

(i) Aktivët financiare

Humbja nga zhvlerësimi i aktivitetit financiar matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë midis vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara të skontuara me normën fillestare efektive të interesit. Aktivët financiare me peshë të rëndësishme individuale zhvlerësohen në baza individuale. Aktivët financiare të mbetura vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që kanë karakteristika të ngjashme. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur. Për aktivët financiare të matura me koston e zhvlerësuar, rimarrja njihet në fitim ose humbje.

(ii) Aktive jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlera e rikuperueshme e aktivitetit duhet vlerësuar. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Shuma e rikuperueshme e një aktiviteti është vlera më e madhe midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme janë skontuar me vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se humbja nga zhvlerësimi nuk do ishte njohur.

n) Standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese në çështje ende të pa miratuara

Politikat kontabël për përgatitjen e pasqyrave financiare janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria në vitet 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018, 2019, pas marrjes parasysh të ndryshimeve në vijim të standardeve të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK):

- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare"** - Iniciativa për dhënie informacionesh shpjeguese (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017),
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat"** - Njohja e Aktiveve tatimore të shtyra për Humbjet e Parealizuara (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2017)
- **Ndryshimet në SNRF 12 për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit 12 do të aplikohen për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017).

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka sjellë ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.



ALBESOL Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Standardet dhe interpretimet e nxjerra, që nuk janë ende efektive nga data e lëshimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë janë paraqitur më poshtë. Shoqëria nuk kishte ndonjë zbatim të hershëm. Standardet dhe ndryshimet që nuk janë të zbatueshme për kompaninë nuk janë shpallur.

- SNRF 9 "Instrumentet Financiare" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- SNRF15 "Të ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët" dhe ndryshimet e mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- SNRF 16 "Qiratë" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2021).
- Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve" Zbatimi i SNRF 9 "Instrumentet Financiare" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentet Financiarë" do aplikohet për herë të parë.
- Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare" - Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 40 "Prona e investuar" - Transferimet e Pronave të Investimit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)" që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)" që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar



ALBESOL Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

- 2019).

- IFRIC 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe Konsiderata paraprake" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Shoqëria ka zgjedhur të mos i adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datave të tyre efektive. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar.

7. Drejtimi i Rrezikut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme në përdorimin e instrumenteve financiarë:

- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut
- Rreziku i kredisë
- Rreziku operacional

Në këtë shënim jepet informacion mbi ekspozimin e Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat e Shoqërisë, politikat dhe procedurat për të matur dhe menaxhuar këtë rrezik, si dhe drejtimin e kapitalit.

7. Drejtimi i Rrezikut financiar (vazhdim)

a) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që shoqëria të hasë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të veta financiare duke dhënë mjete monetare ose aktive të tjera financiare.

Përfaqsa e Shoqërisë në lidhje me administrimin e Rrezikut të likuiditetit është të sigurojë, sa më shumë të mundet, se do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e maturuara, në kushte normale dhe shtrënguese, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikohet dëmtimi i reputacionit të Shoqërisë.

Shoqëria parashikon të përmbushë detyrimet e veta nëpërmjet përdorimit të flukseve të pritshme monetare si rezultat i operacioneve.

Detyrimet më të rëndësishme më 31 dhjetor 2019, janë llogaritë e tjera të pagueshme.

Tabela e mëposhtme tregon flukset monetare të skontuara në lidhje me detyrimet financiare të Shoqërisë bazuar në periudhën e mbetur deri në maturim apo pritshmërisë së flukseve monetare, për shkak se efekti zbritës nuk është material për pasqyrat financiare.

	Më pak se 6 muaj	6 - 12 muaj	Mbi 12 muaj	Totali
Në 000/lek				
Huamartje	-	-	63,359	63,359
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	13,920	47,753	-	61,673
Më 31 dhjetor 2019	13,920	47,753	63,359	125,032

b) Rreziku i tregut

Ekspozimi ndaj Rrezikut të kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit është Rreziku që vlera e instrumentave financiarë do të luhetet si pasojë e ndryshimeve në normat e këmbimit valutor. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj kurseve të këmbimit sjell rritje të fitimeve ose humbjeve nga kurset e këmbimit të cilat njihen në fitim ose humbje. Këto ekspozime

ALBESOL Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

përfshijnë aktivet monetare dhe detyrimet monetare të Shoqërisë të cilat nuk janë të shprehura në monedhën funksionale të Shoqërisë.

Normat e aplikueshme të këmbimit (lekë për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2019
1 EUR	123.42	121.77
1 USD	107.82	108.64

Analiza e pozicionit monetar më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, sipas monedhave të huaja në të cilën ato janë të shprehura është si vijon:

Ekspozimi ndaj Rrezikut të kursit të këmbimit

<i>Në 000/ Lek ekuivalent</i>	Lek	USD	EUR	Totali
<i>Aktivitet Financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme	45,606	-	21,478	67,084
Garanci Bankare	0	-	-	0
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	7,228	9	5,811	13,047
Totali	52,834	9	24,433	80,131
<i>Detyrime Financiare</i>				
Huamarrje	(35,334)	0	(28,025)	(63,359)
Llogari të pagueshme tregtare	(9,566)	-	(38,187)	(47,753)
Totali	(44,900)	0	(66,212)	(111,112)
Më 31 dhjetor 2019	(44,900)	0	(66,212)	(111,112)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Drejtimi i lartë menaxhon rrezikun e normës së interesit nëpërmjet monitorimit të kushteve të tregut dhe aplikimit të çmimeve të nevojshme bazuar në analizën e kostos të secilit produkt. Kreditë e Shoqërisë janë me norma fikse dhe shumica kanë maturitetet fillestar prej më pak se pesë vjetësh.

Ekspozimi ndaj Rrezikut të kursit të këmbimit (vazhdim)*Analiza e ndjeshmërisë të rrezikut nga kursi i këmbimit*

Analiza e Rrezikut nga kursi i këmbimit është bazuar në ekspozimin ndaj Rrezikut të kursit të këmbimit në datën e raportimit si dhe ndryshimet e ndodhura në fillimin e vitit financiar dhe të mbajtura konstante gjatë gjithë periudhës së raportimit. Ndikimi i efekteve të ndryshimit në kursin e këmbimit në fitimin para tatimit, duke i mbajtur të gjithë elementet e tjerë konstantë rezulton me neto në rritje të shpenzimeve për 1,695,433 lekë (nga furnitorët dhe kreditë gjenerohen 1,361,580 lekë e ardhur dhe nga Klientët dhe likuiditetet gjenerohen 3,057,013 lekë shpenzim).

c) Rreziku i kreditë

ALBESOL Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Rreziku i kredisë është Rreziku i humbjeve financiare të Shoqërisë nëse një klient apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë dhe paratë në bankë .

Rreziku i mundshëm i kredisë në marrëdhëniet tregtare ekzistuese me klientët në fund të vitit 2019 zbutet nëpërmjet procedurave përzgjedhëse specifike për ofrimin e shërbimeve, dhe nga kontrollet ditore mbi ndryshimet në ekspozime.

Ekspozimi ndaj Rrezikut të kredisë në datën e raportimit është i kufizuar dhe është paraqitur më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme tregtare	85,239	72,127
Garanci Bankare	0	0
Llogari rrjedhëse në banka	12,883	5,031
	98,121	37,868

Zhvlerësimi

Në 31 dhjetor 2019 dhe 2018, vjetërsia e llogarive të arkëtueshme që nuk ishin të zhvlerësuara ishte si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Në afat	34,942	29,952
Me vonesë por jo të zhvlerësuara	50,297	42,175
Të zhvlerësuara	-	-
Totali	85,239	72,127

Drejtimi pret të mbledhë të gjitha llogaritë e arkëtueshme me maturim në datën 31 dhjetor 2019, përveç llogarisë që rrjedhë nga vetrvlerësimi i shitjes së realizuar nën kosto prej 2,222,032 lekë, e cila ka kaluar në humbje në 2019.

Burimet kryesore të likuiditetit të shoqërisë janë paratë e gatshme dhe të ardhurat e krijuara nga operacionet e saj.

Drejtimi i Rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte dhe jo direkte si pasojë e një sërë shkaqesh lidhur me proceset e aktivitetit, punonjësit, teknologjisë dhe infrastrukturës, dhe si pasojë e faktorëve të jashtëm përveç rrezikut të kredisë, tregut dhe likuiditetit.

Biznesi është nën ndikimin e drejtpërdrejtë të ligjeve dhe rregulloreve që prekin këtë industri. Si rrjedhojë legjislatoni pasues , rregullimi dhe interpretimi i tij, apo ngjarje të tjera mund të ekspozojnë Shoqërinë ndaj rritjes së kostove, të cilat mund të kenë efekt mbi biznesin, mbi gjendjen financiare të Shoqërisë, dhe mbi rezultatet e operacioneve të saj.

Shoqëria është e varur nga funksionimi efikas dhe i pandërprerë i sistemeve të shumta, duke përfshirë sistemet kompjuterike, software dhe rrjetet e telekomunikacionit, si dhe qendrat e të dhënave që janë huazuar nga palët e treta (Schneider). Rreziku i humbjes së pajisjeve, çrregullimi në operacione dhe defektet në sisteme menaxhohen përmes procedurave të administrimit të rrezikut operacional, duke përfshirë kryerjen e vlerësimit periodik të rrezikut operacional, si dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuar nëpërmjet zhvillimit të planeve të emergjencës dhe trajnimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin profesional të punonjësve.

Qëllimi i Shoqërisë është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë me kosto efektive, si dhe për të shmangur procedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional dhe për pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullatore të tjera është përgjegjësi e nivelit të lartë menaxherial.

e) Administrimi i kapitalit



ALBESOL Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

Objektivat e Shoqërisë për administrimin e kapitalit janë që të ruajnë aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, në mënyrë që të sigurohet kthimi për Ortakun e vetëm dhe për të ruajtur një strukturë optimale të kapitalit me qëllim që të ulen kostot e kapitalit.

Shoqëria financohet kryesisht me kapital dhe me hua nga bankat. Politika aktuale e Shoqërisë është të sigurojë se ajo është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj dhe angazhimet për investime kapitale kur maturohen. Në 31 dhjetor 2019, kapitali i Shoqërisë është në shumën (11 000+89,552) mijë lekë (2018: (11000+43,878) mijë lekë). Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ndonjë rregullator.

8. Aktivët afatgjata materiale

	Ndertesa	Makineri e pajisje	Mjete transporti	Kompjuterat dhe pajisje zyre	Aktive jo materiale	Totali
Kosto						
Më 31 dhjetor 2018	37.370.367	15.369.807	7.204.759	3.786.551		63.731.484
Shtesa	4.143.060	1.001.756	5.256.696	2.430.973	7.501.889	20.334.374
Shitja e aktiveve		950.189	730.478	-		1.680.667
Pakësime	367.697			-		367.697
Më 31 dhjetor 2019	41.145.730	15.421.374	11.730.977	6.217.524	7.501.889	82.017.494
Amortizimi i akumuluar						
Më 31 dhjetor 2018	4.336.882	3.537.173	1.740.945	460.364		10.075.364
Amortizimi i vitit	1.746.883	1.275.436	986.856	839.213	1.120.449	5.968.837
Shitja e aktiveve		479.231	417.146			896.377
Pakësime	101.302					101.302
Më 31 dhjetor 2019	5.982.463	4.333.378	2.310.655	1.299.577	1.120.449	15.046.522
Vlera e mbetur						
Më 31 dhjetor 2018	33.033.485	11.832.634	5.463.814	3.326.187		53.656.120
Më 31 dhjetor 2019	35.163.267	11.087.996	9.420.322	4.917.947	6.381.440	66.970.972

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria ka në pronësi Aktive afatgjata materiale në vlerën kontabël 66,970,972 lekë, të vendosura në adresën e vetme të saj në Baldushk. Gjatë vitit 2019 AAM janë pasuruar me blerje në vlerë 20,334,374 lekë dhe janë paksuar me shitje dhe dalje jashtë përdorimit në vlerën 2,048,364 lekë.

Nuk ka pajisje të vendosura si kolateral në 31 dhjetor 2019 (2018: asnjë).

(i) Zhvlerësimi

ALBESOL Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

Si pasojë e ngjarjeve të përshkruara në shënimin 5.a), drejtimi nuk ka kryer një test zhvlerësimi

9. Aktive afatgjata jo-materiale

Aktivet Afatgjata jo materiale janë përfshirë në Tabelën e mësipërme në kolonën e parafundit, dhe kapin vlerën fillestare 7,501,889 lekë dhe e gjejnë shprehjen e vet në LIÇENSËN e ndarë në 3 nivele , të Kompanisë Schneider Electric Industries SAS, Francë “Mbi të drejtën Ekskluzive për përdorimin e Markës së Schneider në prodhimin e Çelave në Shqipëri” . Amortizimi i Aktiveve të patrupëzuara përllogaritet 15 % të vlerës fillesatre me metodën lineare.

10. Llogari të arkëtueshme

	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Më 31 dhjetor 2018</u>
Të tjera llogari të arkëtueshme	85,239,416	72,127,306
Paradhënie të faturuara	20,728,951	61,907,582
Totali	105,968,367	134,034,888

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësohen nga detyrimet e Klientëve me likuidim të mëvonshëm. Informacionet për ekspozimin e Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut dhe humbjet nga zhvlerësimi janë paraqitur në shënimin 7.b) dhe c).

11. Paradhënie dhe parapagime

	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Më 31 dhjetor 2018</u>
TVSH e parapaguar	0	0
Parapagime ndaj furnitorëve	0	2,602,392
Totali	0	2,602,392

12. Garanci Bankare

Garancia bankare prej 267,000 Euro e cila është siguruar 100 % me Linjë Kredie, përfaqëson një premtim kontraktual që ka të bëjë me afatin e shlyerjes së kredisë (BKT) por që në këto pasqyra nuk paraqitet në vlerë meqënëse vlera është e barabartë në Asete dhe në Detyrime, si edhe pasi vlera e përfitueshmërisë do të konsiderohet vitin e fundit të likuidimit të kredisë dhe konkretisht këto garanci maturohen në datat 18/11/2020 për 217 000 Euro dhe në datën 15/05/2020 për 50 000 Euro .

13. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Më 31 dhjetor 2018</u>
Para në banka	12,883,052	5,031,120
Para në arkë	164,267	13,650
Totali	13,047,319	5,044,770

14. Kapitali aksionar

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2019, është 11 000 mijë lekë (31 dhjetor 2018: 11 000 mijë lekë), i përbërë nga një kuotë me vlerë nominale lekë 11 000 mijë lekë. Elona Pulti është pronari i drejtpërdrejtë i Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

15. Huaja

ALBESOL Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Huamarrje në LEK	35,334,000	0
Huamarrje në USD	0	0
Huamarrje në EUR	23,807,961	65,292,393
Totali	59,141,961	65,292,393

Gjatë 2019, Shoqëria ka pasur dy marrëveshje huaje me bankat si më poshtë:

- BKT, Contract no 403C03A181790001 datë 28/06/2018 për 112000 Euro . Më 31/12/2019 gjendja e palikujduar është 90,994 Euro; dhe
- BKT, Contract no 403C01A192000001 datë 19/07/2019 për 19,584,000 Lek . Më 31/12/2019 gjendja e palikujduar është 19,584,000 Lek; dhe
- BKT, Contract no 403C01A1922980006 datë 25/10/2019 për 12,305,000 Lek . Më 31/12/2019 gjendja e palikujduar është 12,305,000; dhe
- BKT, Contract no 403C01A192000004 datë 25/10/2019 për 3,445,000 Lek . Më 31/12/2019 gjendja e palikujduar është 3,445,000 Lek; dhe
- Credins, Contract no 00000048846 datë 29/12/2017 për 166,000 Euro. Më 31/12/2019 gjendja e palikujduar është 136,028 Euro; dhe

Interesi i llogaritur dhe i paguar në vitin 2019, për huatë 5,362 mijë lekë.

16. Llogari të pagueshme tregtare e të tjera

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve	47,753,212	141,606,558
Llogari të pagueshme ndaj Sigurimeve sh sh	673,683	1,057,158
Llogari të pagueshme ndaj Tatimeve	13,245,599	52,500
Llogari të pagueshme ndaj Inst Leasing	4,217,200	2,105,337
Totali	65,370,774	144,821,553

17. Provigjone

Shoqëria nuk ka aplikuar ngritje Provigjonesh, pasi ajo nuk ka njohur ndonjë çështje të mbetur pezull (si p.sh ndonjë çështje gjyqësore apo të ngjashme).Nën gjykimin e saj shoqëria nuk ka vlerësuar me risk të lartë ndonjë klientë ende të palikujduar apo të ngjashme.

18. Të tjera

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Shpenzime të parapaguara të marra në shpenzime	0	(2,602,392)
Të ardhura të shtyra (të faturuara ende të parealizuara)	17,274,126	51,589,653

19. Të ardhurat

Të ardhurat e realizuara përfshijnë si shitjet e mallrave dhe produktit të gatshëm edhe shërbimet e punimet e ofruara , dhe konkretisht :



ALBESOL Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare***(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shitje punime, mallra e PG	672,814,891	316,279,847
Totali	672,814,891	316,279,847

Drejtimi konsideron se faktorët e mëposhtëm përcaktojnë se Shoqëria vepron si biznes:

- shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të inventarit në lidhje me mallrat, dhe ka përgjegjësi të rëndësishme në lidhje me mallrat e shitura,
- Shoqëria mbledh të ardhurat nga klientët e vet dhe të gjitha rreziqet e kredisë përballohen nga vet shoqëria,
- Shoqëria mund të ndryshojë çmimin e shitjes bazuar në treguesit e kostos së llogaritur dhe me marrveshje me blerësit/klientët.

20. Fitimi neto nga shitja e aktiveve

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shitja e aktiveve.	860,750	1,454,090
Kosto e aktiveve të shitura	(784,290)	(284,278)
	76,460	1,169,812

21. Të ardhura të tjera

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat nga grant dhe dhurata	305,200	
Vodafone i ka dhuruar shoqërisë 2 smartphone.		
Totali	305,200	0

22. Shpenzime personeli

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime page	20,786,299	30,804,285
Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,508,717	4,577,011
Totali	24,295,016	35,381,296

Deri më 31 dhjetor 2019 Shoqëria ka patur mesatarisht 36 punonjës.

23. Shpenzime operative

ALBESOL Sh.p.k
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Zëri kryesor i shpenzimeve është **Kosto e materialeve të përfshira në punimet e kryera dhe kosto e mallrave të shitura** të cilat në totalin e tyre për vitin ushtrimor të mbyllur në 31/12/2019 kapin vlerën 457,655,991 lekë, ndërkohë që për vitin ushtrimor të mbyllur në 31/12/2018 kapin vlerën 262,161,588 lekë.

Në **shpenzime të tjera shfrytëzimi** janë përfshirë të gjitha furniturat e nevojshme gjatë zhvillimit të aktivitetit si shërbimet utilitare ; telefoni, ujë, energji; shpenzime konsulencash, projektesh , marketingu e të ngjashme; shpenzime siguri, mirmajtje, karburanti, qeramarrje, shpenzime transporti; shpenzime udhëtime e dieta; taksa lokale , etj të cilat në totalin e tyre për vitin ushtrimor të mbyllur në 31/12/2019 kapin vlerën 41,296,919 lekë, ndërkohë që për vitin ushtrimor të mbyllur në 31/12/2018 kapin vlerën 26,100,602 lekë.

24. Shpenzimi i tatim fitimit

Në bazë të legjislacionit tatimor shqiptar, norma e aplikuar e tatim fitimit për 2019 është 15% (2018: 15%). Tatim fitimi i njohur në fitim humbje për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Tatim fitimi për periudhën	20,190,243	124,065
Tatimi i shtyrë	(0)	(0)
Totali	20,190,243	124,065

Rakordimi i tatim fitimit efektiv	%	2019	%	2018
Rezultati i vitit		130,990,024		(5,758,447)
Tatim fitimi me normën tatimore të aplikuar	(15.00)	19,648,503	(15.00)	0
Shpenzimet e pazbritshme		3,611,597		6,585,545
Tatim fitimi mbi shp e panjohura		541,740		124,065
Totali		20,190,243		124,065

Tatimi i shtyrë përlloraget në bazë të normës tatimore në fuqi prej 15% (2018: 15%).

25. Angazhime dhe garanci

Procedurat ligjore

Nuk ka procese gjyqësore.

Për garancitë referoju pikës 12.

26. Transaksionet me palë të lidhura

Palët konsiderohen të lidhura nëse njëra palë ka aftësinë të kontrollojë ose të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët. Shoqëria ka kryer transaksione me ALBESOL KANADA, Shoqëria si motër.

Volumi i këtyre transaksioneve dhe i gjendjeve të pashlyera në fund të periudhave respektive janë si në vijim:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Shoqëria si Motër:		
Huaja (shënimi 15)	2,855,829	0



ALBESOL Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

27. Ngjarjet pas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim ose dhënie informacionesh shpjeguese në pasqyrat financiare.

ADMINISTRATORI

Bekim SARAÇI

